

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: <u>08 - 11719</u>
Data/Datum/Date: <u>14/02/2025</u>
Shtojca/Doduc/Annex:
<u>PRISHTINA (2024)</u>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija-
 Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.09/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.50/18, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kerveshi, Përmbaruesi Privat e pa prezencën e palës ankuese me datë 24.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-09/2023 i datës 20.02.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 27.01.2023 **si të pabazuara**.

II. Përmbaruesi Privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.50/18.

A r s y e t i m

Me datën 27.01.2023 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat për lëndën P.nr.50/2018, tek i cili rast para përmbaruesit palët kanë arritur marëveshje për pagesë të obligimit me marrëveshje me këste, por pagesa për dy këstet e tjera ka dështuar pas pagesës së parë. Në ndërkohë pronarja si përfaqësuese e vetme e debititorit shpk, ka vdekur.

Pala ankuese si familjar e ka njoftuar përmbaruesin privat duke kërkuar nga i njejti që të pushohet procedura për shkak të vdekjes së pronares si debitore. Sipas palës ankuese lënda ka qenë në vendosje në gjykatë për atakimet e bëra nga debitori lidhur me urdhërin përmbarimor të përmbaruesit, por përkundër që është njoftuar përmbaruesi për vdekjen e pronares së debititorit, përmbaruesi nuk e ka njoftuar gjykatën për këtë rrethanë.

Familja e përfaqësueses së debitores, e cila ka vdekur, ka pranuar në ndërkohë vërejtje për pagesën e taksës lidhur me prapësimin e ushtruar. Për shkak të mos njoftimit të gjykatës nga përmbaruesi për pronaren e debitorit dhe për shkak të taksës gjyqësore derisa e kanë pranuar familjarët, lënda është vonuar në vendosje dhe në vend që të vendoste Gjykata Themelore në Dega në , lënda ka kaluar në kompetencë të Gjykatës Komerciale.Në vazhdim, pala ankuese ka deklaruar se përmbaruesi ka liruar vetëm llogaritë bankare të debitorit, por jo edhe automjetin e debitorit të tipit Dacia me kilometrazhë zero edhe përkundër që pronarja e kompanisë ka vdekur dhe ka amortizim të veturës së bllokuar dhe për këtë shkak ka dëmtime nga veprimet përmbarimore, duke pretenduar që përmbaruesi po mban të bllokuar këtë automjet në mënyrë të kundërligjshme ka parashtruar këtë ankesë me propozim që bazuar në udhëzimin administrativ dhe në dispozitat e LPP-së,përmbaruesit ti shqiptohet masa sipas dispozitave të nenit 368 të LPP-së.Me datën 20.01.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka theksuar se në këtë rast ankesa është parashtruar nga personi që nuk ka autorizim që të parashtruar ankesë, duke pasur parasysh që nuk ka parashtruar asnjë autorizim në emër të debitorit, gjë që shihet edhe në ARBK se ende pronar i debitorit dhe përfaqësues figuron e ndjera .

Debitorja ka parashruar prapësim përmes avokatit dhe pas kësaj edhe ankesë , e të cilat janë refuzuar nga gjykatat dhe pas ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore, debitori është lajmëruar dhe ka arritur marrëveshje për pagesë të obligimit me këste, por pasi që nuk është bërë pagesa edhe sipas marrëveshjes,duke rënë në vonesa prej 4 muajsh,përmbaruesi ka vazhduar me bllokimin e llogarive dhe mjeteve të dëbitorit.

Përmbarues ka bërë lirimin e llogarive dhe jo veturës, pasi vetë pala ka deklaruar se zotohet për pagesë të obligimit me kusht që të lirohen vetëm llogaritë bankare të debitorit. Pala debitore është biznes që duke u bazuar në dispozitat ligjore si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara,për të gjitha obligimet e kompanisë paraqitet vetë kompania me asetet e saj.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese të njëjtin përmbaruesi e kishte sygjeruar që të ndjek rrugët ligjore, sepse nuk është i autorizuar në këtë biznes e duke pasur parasysh shoqërinë me përgjegjsi të kufizuar ka vepruar duke këshilluar kësisoj palën ankuese që pas procedurës së trashëgimisë të rreguloj edhe përfaqësimin dhe ndryshimet në ARBK,me qëllim që ai te jetë përfaqësues i debitorit.I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa e palës ankuese.

Në seancën dëgjimore të dt.14.04.2023, palët kanë mbetur sikurse në kërkesat e tyre të mëhershme,ku pala ankuese ka deklaruar se mbetet ne teresi pranë ankesës së parashtruar lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e përmbaruesit privat. Poashtu ka shtuar se i ka përfillur udhëzimet e dhëna nga përmbaruesi pas vdekjes së vajzës së ish debitorit si e autorizuar e biznesit, ku edhe ka shkuar përmes aktit notarial. Konsideron se sjellja e përmbaruesit privat ka qenë jashtë çdo norme, meqenëse në njëfarë mënyrë ka tentuar të sulmoj babain e të ndjerës ku prezent ka qenë edhe avokati .. Për këtë arësyte ka ushtruar prapësim ndaj lejimit të përmbarimit ku të njejtit i është aprovuar prapësimi nga shkalla e parë, ndërsa shkalla e dyte e ka kthy lëndën në rishqyrtim ne shkallën e parë, ndërsa tanë lënda gjendet ende e pa vendosur ne Gjykaten komerciale, në shkallen e parë. Meqenëse nuk kishtë alternativa tjera iu ka drejtuar Komisionit disiplinor për të ndërmarr masa disiplinore ndaj përmbaruesit privat konform dispozitave ligjore.

Përmbaruesi ka dekluaruar se është e vërtetë se ka vdekur vajza e tjetër që këtu prezent e quajtur '.....' por shtoi se është fjala për Shoqëri Aksionare që e posedon pasurinë e vet aktive dhe pasive dhe nuk është fjala për çështjen e pasurisë personale për te cilën mundet të përgjigjet pretenduesi '.....' ngase ne kontaktet e tyre të rregullta ka kërkuar që ky person duhet te këtë autorizim legjitim për të ndërmarrë veprime të caktuara për shoqërinë aksionare në fjalë. Më tutje ka theksuar se kanë pasur disa kontakte dhe se i ka treguar që nuk ka legjitimitet dhe se nuk ka autorizim. Për me tepër ka shtuar poashtu se mbetet ne terësi pranë përgjigjes së parashtruar me shkrim sepse deri në këtë moment palës ankuese i mungon legjitimiteti për sa i përket çështjes së përfaqësimit të biznesit, ngase çështjet tjera nuk janë kontestuese dhe se ky si përmbarues privat, nuk mund të ndërmerr veprime pa qenë i regjistruar '.....' si përfaqësues ose pronar i Biznesit '.....' sepse nuk është organ ku mund ti ndërroj emërtimet e biznesit.

Me datën 25.01.2024, nga departamenti përkatës i Ministrisë është pranuar raporti së bashku me vendimin e gjykatës, ku është anuluar vendimi i këtij komisioni i marrë me datën 14.04.2023 dhe lënda është kthyer në rivendosje.

Komisioni ka caktuar seancën me datën 24.01.2025, ku në prezencë të përmbaruesit privat, ka administruar të gjitha provat si propozimin për përmbarim, dokumentin mbi bazën e të cilit është vendosur nga përmbaruesi, kërkesat e palëve të parashtruara me shkrim pranë përmbaruesit, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Për Çështje Administrative Ac.nr. 1062/23, të dt.06.11.2024, me vërejtjet konkrete për procedurën e rivendosjes, dhe ka dëgjuar deklarimin e përmbaruesit, i cili ka theksuar se nuk ka diçka të shtoj, përpos që pala ankuese ankesën e tij nuk e ka të bazuar, por që mjeti i blokuar në këtë rast më shumë ka të bëjë me lidhjen emocionale që ka vet pala ankuese, pasi përfaqësuesja e debitorit, tanë ë ndjerë është vajza e tij si palë ankuese. Tek ky rast ka pasur marrëveshje, por ka dështuar pagesa sipas marëveshjes, pretndimet sipas mjeteve juridike janë refuzuar nga gjykata dhe pala ankuese nuk është lajmëruar asnjëherë më për ndonjë zgjidhje të këtij rasti.

Pas seancës dëgjimore, administritimit të deklaratave të palëve me shkrim, procesverbalit të seancës së datës 24.04.2023, vendimit të gjykatës, me të cilin lënda është ktheyr në rivendosje dhe dëgjimit të deklarimit të pëmbraruesit privat në seancën e datës 24.01.2025, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar si më poshtë:

Pala ankuese nuk figuron fare si palë në këtë rast, e as përfaqësues i autorizuar i debitorit, por është familjar i debitorit të vdekur, gjë që edhe në këtë rast pala ankuese nuk do të kishte legjitimitet, por pasi është administruar edhe fakti se këtu apla ankuese është trashëgimtare e përfaqësueses së debitorit dhe trashëgon të drejtat e saj në bazë të aktit me të cilin edhe është kryer trashëgimia, komisioni e ka konsideruar që pala ankuese ka pasur të drejtë të jetë palë në këtë procedurë disiplinore, sepse vepriemi përmbarimore e kanë prekur interesin e tij si trashëgimtar i përfaqësueses së debitorit.

Konstatohet se pala ankuese nuk ka bërë asnjë veprim, me të cilin do dëshmonte tarshëgiminë e biznesit dhe nuk ka bërë ansjë ndryshim në zyrën përkatëse të regjistrimit të bizneseve e aq më pak asnjë lëvizje për zgjidhje të situatës, me kërkesë për arritje të ndonjë pagese me përmbaruesin, duke mos ofruar prova të reja apo rrethana të reja që do detyronin organin përmbarues të veproj mbi ato fakte. Komisioni konstaton se organi përmbarues, veprimet e tij i ka dnërmarrë pasi janë plotësuar kushtet ligjore dhe pasi gjykata i ka refuzuar mjetet juridike të ushtruara nga pala debitore.

Pretendimi i palës ankuese se përmbaruesi nuk e ka njoftuar gjykatën për vdekjen e përfaqësueses së debitorit, me çka lënda është vonuar dhe në vend të vendosjes lidhur me mjetin juridik nga Gjykata Themelore në përmbaruesi për mjetin juridik pastaj ka vendosur Gjykata Komerciale, nuk paraqet bazë për shkelje disiplinore, sepse ka vendosur gjykata kompetente dhe përmbaruesi ka vepruar pasi gjykata ka refuzuar mjetet juridike të debitorit.

Pretendimi tjetër së përse mbahet e bllokuar vetura e debitorit përkundër që ka zhvlerësim për çdo ditë sepse është automjet i pa përdorur dhe do duhej të lirohej nga përmbaruesi, nuk ka paraqet poshtu bazë, sepse përmbaruesi në momentin e arritjes së marrëveshjes me palën debitoren, vet pala debitoren kishte kërkuar lirimin e xhirollgarisë bankare, gjë që edhe është bërë, por në momentin e dëshimit të pagesave, automjeti mbetet i bllokuar për obligimet në këtë lëndë.

Sa i përket pretendimit se debitori ka vdekur e duhet të pushoj procedura, përmbaruesi ka vepruar drejtë kur edhe ka deklaruar që përfaqësuesi i debitorit ka vdekur dhe do duhej vetë familjari, këtu pala ankuese të bëjë ndryshimet në zyre përkatëse të bizneseve lidhur me pronarin e debitorit, sepse biznesi si debitor është aktiv, por kemi vdekjen e pronarit dhe nuk parashihet ndonjë veprim apo kërkesë e kreditorit që të shtyej ose mos veproj, por vet palët me interes duhet të bëjnë ndryshimet në biznesin eventualisht të trashëguar.

Bazuar në këto, në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjëren nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në faktin se përmbaruesi ka vepruar duke u bazuar në shkresat e lëndës ku shihet që veprimet përmbimore janë ndërmarrë pasi janë plotësuar kushtet ligjore të squaluara si më lartë. Vetë pala debitoren ka arritur marrëveshje për pagesë me këste të obligimit, por nuk i është përbajtur asaj marrëveshjeje dhe nuk ka pasur bazë ligjore që të aprovojen kërkesat e palës ankuese për pushim të procedurës apo lirim të automjetit të bllokuar.

Komisioni ka trajtuar të gjitha provat dhe deklarimet e palëve dhe bazuar në ato vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.09/2023 datë 24.01.2025,

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.